




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Procesverbal

Nga Seanca e trembëdhjetë (XIII) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 1.2.2011 në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit me këtë:

Rend pune :

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa**
 - 2/1- Propozim-vendimi për mandatimin e Komisionit statutar edhe për hartimin e Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera,
 - 2/2- Propozimi-vendimi për formimin e Komisionit për përcaktimin e kriterëve dhe të lokacioneve për vendosjen e Busteve, Shtatoreve dhe Lapidarëve të mundshëm për dëshmorët dhe figurat e spikatura,
 - 2/3- Raporti i punës nga Zyra e Prokurimit
 - 2/4- Informatë nga Drejtoria e Arsimit për kandidatët e pranuar në shkollat e mesme dhe fillore,
 - 2/5- Propozim-vendimi për ridestinimin e mjeteve të donatorëve për pasojat breshëritë
3. Të ndryshme

Seanca filloi punimet në ora 10.20

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e seancës së trembëdhjetë (XIII) të KK-së ishin:

Anëtarët e Kuvendit

Drejtorët e drejtorive komunale

Përfaqësuesit e OSB-së

Përfaqësuesit e MPL-së

Mediet

Seancën e trembëdhjetë e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e OSB-së, përfaqësuesit e MPL-së, mediet dhe të gjithë pranishmit e tjerë në sallë.

Sekretaria konstatoi se të pranishëm në seancën e trembëdhjetë ishin të pranishëm gjithë anëtarët e Kuvendit

Izmi Zeka- nëse ka kërkesa për ndryshim ose plotësim të rendit të punës urdhëroni?

Sokol Haziri- z. Haziri theksoi se nuk ka një qartësi në formulim të rendit të punës për takimin e sotëm, sepse në seancën e kaluar (dje) nuk u dha asnjë informatë lidhur me kontrollin të cilin e ka bërë eulex-it në Komunën e Gjilanit, nuk e kam të qartë a është sot në rend pune ky sqarim?

Në KPF është thënë nga kryetari se do t' i informojë edhe këshilltarët me këtë çështje?

Izmi Zeka- nuk do të jetë problem, këtë informatë do ta jap edhe unë në fund të rendit të punës, por kjo është sqaruar disa herë, ka qenë në mjete të informimit dhe të gjitha grupet parlamentare i kemi njoftuar, por dhe për kundër kësaj ne mund ta japim edhe një informatë.

Sokol Haziri- unë jam në pajtim lidhur me atë që e thotë z. Kryesues, por ne kemi marrë qëndrim në KPF, por dhe kryetari ka pasur vullnet që t' i drejtohet këshilltarëve lidhur me këtë!

Izmi Zeka- duhet t' i njoftojmë të gjithëve, tash e tutje më pikën të ndryshme dhe nuk e fusim asnjë pikë, sepse rendin e punës po bëjmë me shefa të grupeve dhe aty mund të futen të gjitha çështjet, e jo kur të vijmë në seancë të bëjmë propozime adhoc.

Arben Mehmeti- sa për sot po iu njoftoj se në të ndryshme kemi disa gjëra në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë.

Izmi Zeka – propozoj që të deklarohe mi për këtë rend pune?

Aprovohet rendi i punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

2/1- Propozim-vendimi për mandatimin e Komisionit statutar edhe për hartimin e Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve të tjera,

Izmi Zeka- z. Kryesuesi theksoi se ne deri më sot nuk e kemi ndonjë rregullore të veçantë se si dhe në çfarë mënyre ndahen, mirënjohjet, titujt e ndryshëm dhe shpërblimet e tjera. Ne me shefat e grupeve parlamentare kemi menduar për ta bërë një rregullore të tillë dhe në bazë të kësaj të përcaktojmë se cilat personalitet mund të shpallen qytetarë nderi dhe kush mund të marrë mirënjohje dhe shpërblime të tjera.

Për përpilim të kësaj Rregulloreje ne kemi menduar që të mandatohet, komisioni i cili e ka hartuar Statutin e Komunës.

Bahrie Veseli – të nderuar këshilltar dhe ju kryesues, isha në dyshim a të flas apo jo! Këtë po e them se edhe me këtë rast përsëri ka shkelje të drejtave të njeriut, por në veçanti të asaj për barazi gjinore. Edhe ky komision e ka përjashtuar gjininë femërore dhe kjo më nuk ka kuptim dhe unë abstenoj për këtë rast.

Izmi Zeka- nuk ka nevojë të na përmendet disa herë një çështje, urdhëroni këtë çështje bisedoni me shefat e juaj dhe merrni vesh në partitë e juaja. Unë nuk kam kompetencë t'iu imponojë juve anëtarët e komisionit, prandaj ju nëpër komisionet e juaja i duhet t'iu sjellini këto propozime.

Sokol Haziri- ne si grup i AAK-së, e mbështesim këtë propozim dhe nuk kemi nevojë ta ndërrojmë kandidatin tonë. Mirëpo dua të sqaroj një çështje se parimisht kjo barrë i bie partive politike për t'iu rregulluar çështjet edhe gjinore edhe barazive të tjera, por duhet ditur se gjithherë dhe gjithkund vlen parimi, sepse komisionet e përhershme dhe ato adhoqe, këtu janë disa komisione adhoqe.

Ne mbështesim në tërësi këtë propozim-vendim, duke kërkuar që në një seancë Kuvendi ky komision që ka punuar në hartimin e Statutit të KK-së së Gjilanit të thirret në Kuvend dhe t'iu sqarojë këshilltarët me të gjitha të arriturat, sepse nuk kam njohuri se a kanë qenë unik gjatë tërë punës.

Arben Mehmeti- edhe ne i qëndrojmë asaj që jemi marrë vesh, pa marrë parasysh kërkesave të gjinisë femërore, sepse vendimet janë marrë dhe qëndrojmë pranë atij vendimi.

Ejup Haziri- edhe ne e mbështesim këtë propozim, edhe pse ky komision e ka kryer 90% të punës, kurse tash është diku kah fundi, por ne e mbështesim si të tillë.

Ibrahim Neziri- edhe ne si grup G-3 e mbështesim

Jakup Bajrami- edhe ne mbështesim si grup i LDD-së, por nuk kemi bërë as ndryshime

Izmi Zeka- një ndryshim te numri 10, në vend të Asllan Ismaili, anëtar është bërë një ndryshim dhe duhet të jetë Renan Imami

Izmi Zeka- kush është për mandatim të këtij komisioni ?

Aprovohet pika 2/1 e rendit të punës me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 13 ishin abstenime

2/2- Propozimi-vendimi për formimin e Komisionit për përcaktimin e kritereve dhe të lokacioneve për vendosjen e Busteve, Shtatoreve dhe Lapidarëve të mundshëm për dëshmorët dhe figurat e spikatura,

Izmi Zeka – edhe për këtë pikë të rendit të punës jemi marrë vesh me shefat e grupeve parlamentare, nëse ka dikush për të plotësuar diçka urdhëroni?

Ejup Haziri- në emër të grupit të PDK-së e propozojmë Shpresë Jahirin si anëtare të këtij komisioni.

Sokol Haziri- në emër të grupit të AAK-së e propozojmë Sami Azmein, për anëtar të këtij komisioni.

Arben Mehmeti - grupi parlamentar i LDK-së, propozon z. Remzi Hajrullahun

Grupi parlamentar i LDD-së dhe AKR-së, u deklaruan se do t' i sjellin emrat më vonë.

Kryesuesi, z. Zeka propozon që anëtarët e Kuvendit të deklarohen për aprovim të këtij propozim-vendimi?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit, pika 2/2 e rendit të punës

2/3- Raporti i punës nga Zyra e Prokurimit

Izmi Zeka- lidhur me këtë raport po theksojmë se ka qenë një kërkesë e opozitës që të jetë në rend të punës, për të cilin raport i keni materialin komplet të kësaj zyre, për të cilin raport kemi debatuar edhe në KPF, prandaj e lus shefen e Zyrës së Prokurimit, znj. Hatixhe Daku që të na raportojë, por të jetë e shkurtër, sepse materialin e kanë pasur të gjithë këshilltarët.

Hatixhe Daku- raportin e keni të gjithë, por unë do ta bëj një përshkrim të shkurtër të punës së prokurimit i cili është bërë brenda vitit 2010. Puna e Zyrës së Prokurimit gjatë tërë këtij viti kryesisht është bazuar në Ligjin mbi prokurimin i cili ka qenë në fuqi gjatë tërë vitit 2010. Në bazë të këtij ligji Zyra e Prokurimit çdo vit e përgatit një raport vjetor për të gjitha kontrata e nënshkruar publike të cilin raport e dorëzon edhe në Komisionin rregullativ publik në Prishtinë. Raporti është standard dhe i përmbajnë të gjitha të dhënat, datën e kontratës, numrin e prokurimit, operatorin ekonomik, vlerën, selinë e operatorit ekonomik, formën e kritereve të cilat janë përdor të cilat i keni edhe në raportin të cilin ia kemi sjell për seancë.

Në këtë zyrë punojnë 5 zyrtarë dhe shefja e prokurimit dhe të gjithë janë të certifikuar në bazë të ligjit dhe të licencuar për të punuar në punë të prokurimit.

Në vijim të fjalës së saj znj. Daku filloi për ta sqaruar raportin sipas radhës, të cilin raport këshilltarët e kanë marrë me kohë së bashku me materialin e nevojshëm për seancë.

Arben Mehmeti- së pari kam një pyetje për menaxheren e Zyrës së Prokurimit:

Zonja në fjalë i përmendi disa herë ligjet dhe rregulloret, prandaj do të kisha kërkuar prej saj se në bazë të cilit ligj caktohen organet mbikëqyrës, komisionet për pranime teknike dhe ato të vlerësimit etj. ? Këto të specifikohen dhe përgjigjen e dua në fund.

Menaxherja nuk i përmendi rastet shkeljes së ligjit të cilat kanë ndodhur në këtë zyre, por i përmendi indirekt për pa bërë specifikime.

Unë po i përmendi disa shkelje: së pari është raporti i Departamentit të Prokurimit i cili është i muajit të tretë 2010 i cili është dorëzuar me 26.4.2010, kurse ai final është 10.5 2010.

Në këtë raport te deklarata e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve, neni 8.6 i Ligjit të prokurimit publik thotë: “ka shkelje të ligjit në nenin 8.6 të prokurimit publik.

Te komisionet për hapje dhe për tri aktivitete të prokurimit janë me numra të specifikuara dhe thuhet se: “nuk ka dëshmi të vendimit për hapje”, kurse kjo paraqet, shkelje të nenit 28.1 të Rregullores së prokurimit publik.

Tek deklaratat nën betim të anëtarëve të Komisionit për vlerësim thuhet; “ndërsa së paku për një aktivitet të prokurimit me numër të protokollit 651/08 029/121, thuhet se anëtarët e komisionit vlerësues nuk i kanë nënshkruar deklaratat nën betim dhe kjo paraqet shkelje të nenit 20.2 të Rregullores së prokurimit publik.

Te mbikëqyrja e njoftimeve për vlerësimet e aktiviteteve të prokurimit të AK: Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar nëni 52 i LPP-së. Është vërejtur se autoriteti kontraktues do të thotë Komuna gjatë kryerjes së prokurimit për pesë aktivitete të prokurimit nuk e ka bërë njoftimin operatorit ekonomik mbi eliminimin dhe arsyen e eliminimit të tyre e cila gjë paraqet shkelje të nenit 52. 1 të LPP-së.

Në vijim të fjalës së tij z. Mehmeti i paraqiti edhe shumë shkelje të tjera të ligjit, por në sekretari e dorëzoi komplet Raportin e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Monitorimit në të cilin raport i kishte fiksuar dhe nënvizuar të gjitha shkeljet dhe nenet të cilat është bërë shkelje. Në të gjitha nenet ku është bërë shkelje, këshilltarët mund ta vërejnë, sepse ato janë të nënvizuar me ngjyrë të verdhë, ose të nënvizuara me laps.

Zijadin Maliqi- Unë e kam bërë analizën e raportit edhe këtë të sotmin, por edhe për atë që u debatua diku në muajin dhjetor të vitit të kaluar dhe kam konstatuar se janë bërë disa aktivitete të prokurimit në kundërshtim me Ligjin e prokurimit.

Në bazë të raportit del se tek procedurat e hapura janë 36 prokurime, kuotim të çmimeve 75, procedurë për vlera minimale 40 etj. Unë mendoj se ka qenë desh të jetë dhe duhet të jetë me procedurë të hapur numër shumë më i madh, afër 120.

Kuotim të çmimeve numër shumë më i vogël, afër 40. Ligji i prokurimit e përcakton shumë mirë se ku duhet procedurë me kuotim të çmimeve, kurse me kuotim të çmimeve shkohet në vlera deri në 10 mijë euro, kurse për punë nuk ka procedurë me kuotim të çmimeve.

Në raport kemi një numër mjaft të madh të punëve që kanë shkuar me kuotim të çmimeve dhe kjo do të thotë se kemi shkelje të Ligjit të prokurimit në nenin 35 pika 1 dhe 2.

Kjo do të thotë nuk mund të shkojmë me kuotim të çmimeve për punë si shembull i tillë është aty ku thuhet: “ shpimi i pusit për nevojat e shkollës të Qarku”, apo siç ka raste ku thuhet furnizim me asfalt për një rrugë etj.

Nuk e di pse është bërë furnizimi me asfalt, ajo është punë, punë kryesi është i obliguar ta kryej punë edhe me asfalt dhe material tjetër të nevojshëm?

Tek kuotimi i çmimeve përsëri, sepse aty ka çmim afër 10 mijë euro, sepse në bazë të ligjit duhet të jenë së paku tre operatorë të përgjegjshëm. Këso raste kemi tek shpimi i pusit 9940 euro e cila është dhënë sipas kontratës me çmim më të ulët, por nuk dihet sa kanë qenë ato dy tjerat? Tjetër vërejtje është se ka kontrata të cilat janë lidhur në muajin e 12 kur kanë përfunduar të gjitha afatet rreth përmbylljes së vitit financiar dhe zotimeve e cila gjë do të thotë janë bërë kontrata pa zotimin e mjeteve.

Me Ligjin e prokurimit nëni 20 iniciimi i aktiviteteve të prokurimit nuk guxon të bëhet pa zotimin e mjeteve, por me një Udhëzim administrative kjo është lejuar dhe mund të bëhet iniciimi i prokurimeve pa zotimin e mjeteve, por në asnjë mënyrë të lidhet kontrata pa zotimin e mjeteve. Në raport shihet se ka shumë kontrata pa zotim të mjeteve.

Edhe një pyetje, sepse po dyshoj, por dëshiroj të mos jetë ashtu: “ a ka kryerje të punëve e pastaj procedura për prokurim”? Dyshoj që ka dhe ajo është shumë e rëndë!

Abdyl Aliu- unë e kam analizuar raportin dhe kam parë se vlera e kontratave gjatë vitit 2010, sipas kriterëve për dhënie të kontratave, nga raporti tabelar del se janë përdorur dy kriterë! Çmimi më ulët është diku mbi 73% dhe është kriteri tjerë ekonomikisht më i favorshëm mbi 26%, mirëpo më e mirë do të ishte që kontratat t' i epen të gjithë operatorëve të cilët kanë pasur çmim më të ulët.

Unë mendoj se përqindja mbi 26% është kriter më i favorshëm, mirëpo sipas këtyre kriterëve kuptohet se kontrata mund të lidhet me një operator i cili e ka çmimin më të shtrenjtë dhe për këtë kam dyshim se këtu ka shkelje të ligjit.

Së pari neni 50 pika 10.1 i këtij ligji thotë: “autoriteti kontraktues në këtë rast KK-, duhet të specifikojë një njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit, sepse tenderi i epet operatorit ekonomik i cili ofron çmim më të ulët, ose tenderi epet operatorit ekonomik i cili paraqet çmim më të favorshëm”.

Për këtë unë pyes : “ a kanë qenë të specifikuara të gjitha këto në njoftimin të kontratës, por dhe në dosjen e tenderit ?“.

Në emër të grupit të LDK-së, kërkoj që të sigurohemi për rrjedh të mirë të këtyre kontratave dhe kjo nënkupton se duhet të na sigurohet lista e kontratave me vlerësime të punës së komisioneve.

Gjatë fushatës zgjedhore vitin e kaluar një kompani gjilanase ka shtruar disa rrugica me zhavorr në lagjen “Z. Sahit Agës”, por ato rrugica nuk figurojnë në raport askund? Për këtë shtroj pyetjen si qëndron puna me këtë projekt?

Thuhet furnizim me radiator për Palestren e Sporteve në Gjilan 9952.00 euro, por dje u tha se nuk ka nxehje në Palestër, këtu na del diçka e pa efekt?

Tjetër është pastrimi rrugëve, parqeve dhe varrezave, 152 mijë, por këtu i kisha heq mirëmbajtjen e varrezave, sepse punë të tilla nuk kam parë se janë bërë?

Në raport thuhet : “furnizim me material në rrugën “ V. Maliqi”, në vlerë prej 9846.00 euro por në raport del se në raportin e parë del se punën e ka kryer kompania “Pika 5 A”, kurse tash “Magjistranja”, është gabim teknik, apo çka është në pyetje?

Edhe një vërejtje tek caktimi i organeve mbikëqyrës, dhe pranim teknik, kam hasur në disa raste ku gjendet emri i menaxheres si organ mbikëqyrës e cila gjë është konflikt interesi dhe shkelje e ligjit.

Ramiz Ramadani- u ngrit një problem të cilin e tha z. Abdyl dhe pajtohem me atë se janë disa projekte të cilët kanë ndodhur, por nuk figurojnë në këtë raport dhe për këtë kam pasur qëllim që të shkojë në Zyre të Prokurimit” për t' i marrë informatat.

Në fshatin Llashticë ka ndodhur asfaltimi i dy rrugicave dhe një në Zhegër, por nuk figurojnë fare në raport. Dua një sqarim nga menaxherja?

Tahir Arifi- unë mendoj se është bërë një punë e mirë me këtë raport sidomos në drejtim të transparencës lidhur me atë që ndodh në Zyrën e Prokurimit. I vlerësoj edhe angazhimet e atyre që folën deri më tani dhe që kërkuan që të sqarohen disa gjëra dhe besoj se menaxherja do ta bëjë këtë sqarim.

Nëse keni dëgjuar me vëmendje atë që e tha dje kryetari i Komunës, krahasuar me atë që u tha sot, u ngritën dyshime për tejkallim të procedurave po e quaj unë. Mirëpo ne i kemi të qarta problemet dhe mjetet që nuk i ka lëshuar Qeveria për Komunën e Gjilanit, por edhe atë që e dëgjova nga kolegët e mi, dëshiroj që ato vërtetë të sqarohen? Unë në asnjë moment nuk

pash se ka shkelje të natyrës e cila do ta cenonte Zyrën e Prokurimit dhe nëse ka tejkallim të procedurave, sepse ka qenë desh të kryhen punët në një kohë të caktuar.

Unë desha të mbështesë angazhimet e opozitës dhe besoj se menaxherja do t' i sqaron të gjitha dyshimet që u ngritën.

Bahrie Veseli – jam kureshtarë ta di edhe unë, sepse në lagjen time ku jetoj është shtuar një rrugë, por ato shtëpi afër asaj rruge nuk posedojnë as leje, prandaj dëshiroj ta di pse nuk figuron ajo rrugë në listën e punëve të kryera e cila rrugë është e shtruar me zhavorr?

Elisah Ymeri- e përshëndes raportin e menaxheres, përshëndes kontributin e opozitës, por veçanërisht e përshëndes shafen të cilën e inkurojmë për një punë më të mirë. Edhe ne mund të kemi ndonjë vërejtje, kjo është e natyrshme, por raporti në përgjithësi është shumë i mirë. Mua më nxiti të reagoj parafolësja e ime dhe sa jam në dijeni unë aty është fjala për rrugën (te) rruga “Shaban Hajdari” e cila është shtruar me vetiniciativë, por ajo zonjë na fyejti se po qeshim. Nuk e kam të qartë me cilin kod të mirësjelljes është e ndaluar për të qesh këshilltarët komunal

Ju kisha lut të paktën të jemi më korrekt në punën tonë, ne jemi për punë e jo për të shpif.

Lidhur me raportin po e them se dikur imazhi i Komunës ka qenë në nivelin e duhur, kurse sot e kemi një imazh si Komuna më e mirë në Kosovë. Unë në fund të fjalës sime do të kisha preferuar që emrat sa më pak të përsëriten.

Arben Maliqi- unë mendoj se kjo zyre është një zyre me shumë rëndësi në Komunën tonë në të cilën zyrë është bërë një punë e madhe, por edhe pse nuk jam profesionale në këtë lëmi, por si shef i grupit do t' i them disa fjalë: menaxherja ka bërë një punë të mirë së cilës i ka zili shumëkush? Por ka disa gjëra që mund të quhen edhe qesharake, sepse mund të hidhen dy-tre kamion zhavorr diku në mënyrë vullnetare dhe të shënohet në raport, atëherë do të ishte një raport shumë i gjerë. I kam dy pyetje; 1. Cilat janë arsyet e anulimit të tenderëve? 2. A është e logjikshme që gjithmonë t' i epet kontrata atij i cili është më i lirë i cili në fakt na del më i shtrenjtë?

Ejup Haziri- e kam një kërkesë e cila nuk i takon Zyrës së Prokurimit, por nëse ka mundësi të na ndihmojë në të ardhmen lidhur me vendim të cilin e kemi shtyrë dje, të na epet përgjigje, ku është problemi dhe çka mund të na ndihmojë se çka është e jashtëligjshme?. Me këtë përgjigje e falënderoj edhe Zyrën e Prokurimit?

Izmi Zeka- ne vendim të cilin e kemi shtyrë dje, sepse iu kemi drejtuar Zyrës Ligjore për të shpallë tender për kompani, sepse tash kompanitë e bëjnë mbikëqyrjen e punëve dhe tenderëve të ndryshëm. Kompania tash e merr për obligim mbikëqyrjen, Komuna mund ta bëjë një marrëveshje me ata, por nuk mund t' ia marrë atë të drejtë, sepse kompania duhet të jetë e licencuar për mbikëqyrje.

Sa i përket raportit duhet ta dini se me sa unë jam i njohur në Komunë janë nënshkruar mbi 200 kontrata dhe në aspektin teknik ka pasur defekte, por ne gjatë rrugës jemi në përmirësim e sipër. Zyra e Prokurimit në 10 vjetshin e fundit ka qenë zyra më transparente dhe e ka bërë punën në nivelin e duhur.

U tha se janë përmendur disa rrugë gjatë fushatës, por ka raste se kanë mbetur për pa u përfshirë në raport, por ka raste ku ka pasur edhe aspekt vullnetar siç është ajo te “Kodra e

Thatë” Një po them publikisht se dimë se ndonjëherë ka vonesa dhe nëse ne nuk i iniciojmë procedurat, atëherë punët do të na mbesin në gjysmë. Unë konsideroj se ka qenë një performancë e mirë, por duhet theksuar se Zyra e prokurimit është pjesa më e ndjeshme në Komunë. Me atë numër të njerëzve që ka kjo zyre, shefja ka bërë maksimumin e mundshëm, sepse edhe numri i njerëzve nuk është i mjaftueshëm.

Edhe herëve tjera do t’ i keni të gjitha materialet, por këshilltarët mund të shkojnë në zyre dhe të kërkojnë shpjegime.

Elisah Ymeri- unë kërkoj interpretim ligjor për vendimin të cilin e kemi marrë dje, sepse nëse ky vendim është në kundërshtim për këshilltarë komunal, do të duhej të jetë në kundërshtim me ligjin edhe për shefat e grupeve parlamentare. Kërkoj sqarim me shkrim nga Zyra Ligjore në seancën e ardhshme?

Hatixhe Daku- së pari po them se Ligjin e prokurimit disa e kanë lexuar, por ka edhe të tillë që vetëm kanë dëgjuar për prokurimin. Prej inicimit të kontratës e deri në nënshkrim të kontratës është përgjegjëse menaxheri-(ja) i (e) prokurimit. Në zyre të prokurimit me nënshkrim të kontratës përfundon mbikëqyrja dhe pranimi i projekteve. Unë e nënshkruaj kontratën dhe pastaj është organi tjetër mbikëqyrës që e bën pranimin teknik.

Komisionet e dini se janë caktuar me vendim të Kuvendit, kurs emrat i ka caktuar kryetari të cilën urdhëresë e posedoj këtu.

Mbikëqyrja dhe pranimi, u kërkua sqarime, pse është në kundërshtim ai ligj? Vërejtje që më është bërë nga DMM është se pse e kam zbatuar vendimin e Kuvendit?

Mua edhe nga ndërkombëtarët më është thënë se e ke zbatuar një vendim të Kuvendit, por e ke shkelur Ligjin e prokurimit. Unë atë e kam bërë me vetëdije dhe e kam ditë se e kam shkel ligjin, por e kam respektuar një vendim të organit tonë.

Për mbikëqyrje po e theksoj se Ligji i prokurimit nuk e parasheh mbikëqyrjen edhe pranimin teknik të kontratave. Mirëpo me një Udhëzim administrative nga KRPP ku thotë se inspektimi i projekteve duhet të bëhet nga një kompani e zgjedhur me një procedurë të prokurimit.

Unë jam përgjegjëse për çdo kontratë dhe ka pasur raste kur edhe kam dal në terren dhe kam konstatuar se si po shkojnë punët përkritazi me zbatim të ndonjë projekti dhe nuk është bërë asnjë konflikt interesi.

Nëse unë e kam shkel ligjin dhe kam qenë në organin mbikëqyrës, jam e mendimit se edhe kërkesa e juaj që kërkoni që këshilltarët të jenë në organin mbikëqyrës është në kundërshtim me ligjin.

Deklarata e nevojave dhe disponishmëria e mjeteve të cilën e përmendi z. Arbeni, me ligj të prokurimit në çastin që e marrim inicimin prej kryetarit ne duhet ta bëjmë edhe deklaratën. Mirëpo për ta pasur deklaron e nevojave ne duhet t’ i kemi mjetet e alokuara të cilën e nënshkruan drejtori i Buxhetit dhe kryetari i Komunës. Kjo u tha edhe dje në seancë se nuk mund t’ i kemi mjetet në fillim kur të fillojë procedura, sepse ato ose janë të hyra të Komunës, ose janë donacione, por kem edhe projekte të cilat janë në bashkëfinancim me Qeverinë dhe në këtë rast e nënshkruajmë kontratën në bazë të marrëveshjes që e kemi me ministrinë, sepse nuk mund të presim derisa t’ i sigurojmë mjetet nga Komuna dhe ta bëjmë alokmin e tyre.

Tek komisionet për hapje të ofertave nuk ka pasur dëshmi, por më 2009 me Ligj të prokurimit neni 8 thotë: “ hapja e ofertave bëhet nga zyrtari i prokurimit dhe nuk përmendet

as në ligjin e ri se duhet pasur komisione”. Komisioni është i përcaktuar me një rregullore, por është më vonë dhe ndodh që lëndët që i ka kontrolluar KRPP mos të jetë komisioni, sepse kemi filluar më vonë më 2010, kur e kemi marrë rregulloren për formimin e komisioneve.

Nuk është nënshkruar deklarata për vlerësim është një vërejtje, por këto ndodhin janë gabime teknike, por mendoj se nuk është ndonjë shkelje serioze.

Vërejtje tjetër është mos njoftimi për operatorët eliminues, është e vërtetë se kjo është me ligj të prokurimit, por për shkak të ngarkesave të shumta që i kemi, nuk arrijmë për t’ i përgjigj operatorëve ekonomik të cilët janë të eliminuar, por ka raste që këto i bëjmë në formë elektronike dhe ka raste që në këtë formë bëjmë edhe gabime teknike.

Thuhet se nuk ekzistojnë dëshmitë, por me përgjegjësi mund të them se ndoshta ka ndonjë rast, por 99% ky kusht është plotësuar dhe nëse kërkohet në kontratë në kontratë sigurimin e ekzekutimit të punëve, atë e kemi.

E kemi një furnizim shtesë me vlerë 17% të tejkalim të vlerës së kontratës, por kjo është për mirëmbajtjen verore të rrugëve i cili tejkalim është bërë me vendim të kryetarit për shkak të sezonës, sepse rrugët kanë qenë të ngarkuara shumë, sezona e vjeshtës ka filluar dhe nuk kemi pasur mundësi të shpallim tender dhe me vendim të kryetarit e kemi bërë një tejkalim.

Është vendimi i kryetarit në lëndë dhe nuk është tejkalim që është bërë nga Zyra e Prokurimit.

Është një vërejtje tjetër se kemi shtim të vlerës së kontratës për organin mbikëqyrës dhe pranimin teknik, kjo vërejtje është e vërtetë dhe ekziston edhe në raport të auditorit gjeneral dha atij të brendshëm, por u përgjigja edhe më herët se ky është vendim i Kuvendit. Mirëpo në kontratë është shumë e qartë, sepse shkruan vlera e ofertës sa është, pastaj sipas vendimit ku theksohet vendimi i KK-së dhe nr. i vendimit që rritet vlera e pranimin teknik.

U tha se është një konflikt në mes kompanisë dhe organit mbikëqyrës, por edhe kompania mund ta kontrollojë atë organ mbikëqyrës, por ne nuk e kemi filluar me këtë, por kjo është prej kohës kur ne kemi filluar me realizim të projekteve ndoshta prej vitit 2000, por ka qenë 1% e vlerës së projekteve.

Është një pyetje nga Z. Maliqi pse kemi shkuar me ftesë me furnizim kur kemi pasur punë? Për këtë rast janë dy arsye njëra është se ne i kemi thënë furnizim për shkak të kodit të pagesave, për të kaluar përmes kodit të furnizimit dhe duke parë parasysht se furnizimi e ka kaluar 50% të kontratës, për të cilin rast në ligj thotë se nëse vlera e kontratës kur e kalon 50% të kontratës është furnizim, por nëse është mbi 50% punë duhet të jetë kontratë për punë.

Desha të them se Ligji i ri i prokurimit i lejon të shkohet me ftesë për kuotim edhe tek kontratat për punë, por tek ndonjë kontratë për mirëmbajtje. Unë në këtë rast siç po shihet vetëm kam qenë pak para ligjit, sepse tash ligji i prokurimit i parasheh.

Zijadin e thotë shumë prej 10 mijë euro ftesë për kuotim, kurse pse tjetra 9994, por ajo është e kuptueshme, sepse vetëm për 1 euro mund të ketë dallime në oferta, por ne si përfitues të përgjegjshëm i zgjedhim në bazë të dokumentacionit, kurse përfitues do të jetë ai me çmim më të ulët.

Është edhe një pyetje se ka raste kur janë kryer punët e pastaj janë bërë kontrata, por në këtë rast mund të them se ndoshta ndonjëherë ka pasur raste të tilla për raste emergjente për ndonjë punë e cila nuk pret.

Ju faleminderit për mirëkuptim u mundova të jap sqarime, por nëse ka pyetje plotësuese mund të urdhëroni.

Arben Mehmeti- unë ato që i thash dhe që i lexova janë shkelje zyrtare dhe bëhet fjalë për 5 nene të ligjeve në fuqi, bëhet fjalë për shkelje të Rregullores së prokurimit publik edhe aty janë dy shkelje. Unë jam i mendimit që menaxherja e prokurimit, duhet shumë seriozisht ta shqyrtojë pozicionin e sajë.

Përveç kësaj ka edhe shkelje të vendimit të KK, për të cilat i paska adresuar vërejtje komisioneve mbikëqyrëse si, psh është neni 3. i KK në të cilën thuhet anëtari i komisionit mbikëqyrës duhet të jetë i kualifikuar në lëmi përkatëse profesionale me përgatitje profesionale superiore. Ne në këto organe kemi njerëz me kualifikim të mesëm dhe përgjegjësia për këtë bie mbi ata që i kanë caktuar këta njerëz në organe mbikëqyrëse dhe pranime teknike.

Është mirë që të kenë kujdes çdo zyrtar që mos të bëhen këso shkelje të ligjeve

Sokol Haziri- unë nuk do ta komentoj fare as raportin as përgjigjen e Zyrës së Prokurimit, por kam një vërejtje në Kuvend, në kuptimin e asaj se sa ne u krijojmë hapësirë tepër të madhe atyre që raportojnë para këtij organi ose informojnë këtë organ. Unë iu lus që në të ardhmen për të cilën u dakorduam dje që të kem një limit kohor për t' i shprehur mendimet tona, qoftë si shefa të grupeve, qoftë si këshilltarë. Është torturuese që unë tri orë ta dëgjoj dike dhe të përsëriten me dhjetëra herë fjalitë e njëjta. Unë këtë vërejtje e kam shumë serioze dhe kërkoj që të kemi konsideratë, sepse Kuvendi është organi më i lartë i qeverisjes në Komunë dhe ata që raportojnë këtu i raportojnë Kuvendit.

Jam i bindur se edhe përkundër vërejtjeve shumë serioze që u thanë këtu, flitet vazhdimisht se Kuvendi e ka shkel ligjin, kryetari e ka shkelur ligjin, kemi shkuar para ligjit dhe iu lus që këso gjëra në Kuvend të mos përsëriten.

Zijadin Maliqi-unë i dëgjova përgjigjet, por po e them se është një raport i mirë i prezantimit të punës, por ka edhe lëshime teknike, mirëpo kam pasur dëshirë që të jetë edhe kryetari këtu, sepse kjo është një çështje mjaft e ndjeshme.

U tha nga menaxherja se është bërë me vendim të kryetarit të Komunës, por unë jam i mendimit se ky vendim nuk është në rregull.

U tha se kontrollimi i projekteve pas lidhjes së kontratës e kjo po bien ndesh ma atë që prokurimi përfundon me lidhje të kontratës, të cilin veprim e kam bërë edhe unë, por e kam parë se është gabim dhe ligji ka dalë më 2007.

Znj. Menaxhere punën prej lidhjes së kontratës duhet t' ia lënë Zyrës së Projekteve, kjo zyre duhet të merret me atë apo kryhet puna apo jo?

E kam vërejtur se ka bukur shumë tenderë të anuluar dhe e di se një tender me siguri 5 herë, por ndoshta edhe 6 herë është shpall dhe anuluar derisa është arrit qëllimi për ta marrë një firmë e caktuar.

Tejkalimi i 10% nuk e ka të drejtë kryetari të lëshojë vendime të tilla, atë të drejtë e ka vetëm Agjensioni i Prokurimit.

Pagesat e komisioneve nuk është gjet mënyrë tjetër, sepse ajo është prej vitit 2003 të cilat parashihen edhe në kontratë dhe nuk del se ato i ka bërë punë kryesi.

Te zotimet ligji e jep ashtu edhe te ligji mbi prokurimet, por edhe te Ligji mbi menaxhimet e financave.

Asnjë punë nuk guxon të kryhet për pa u zhvilluar procedurat dhe nuk e di asnjë rast të tillë derisa kam qenë në Zyrë të Prokurimit, me përjashtim të vlerave minimale nën 1 mijë euro. Po dyshoj se mos ka punë me vlera bukur të mëdha që janë kryer pa procedura?

Tahir Arifi- unë e falënderoj menaxheren e prokurimit për sqarimet që na i dha, por ne dje patëm një debat që t' i favorizojmë kompanitë vendase dhe unë dëshiroj sinqeritet nga të gjithë ne dhe sinqerisht dua më tepër sinqeritet për këto raporte që po flasim.

Nëse unë e kam kuptuar drejt, menaxheren në mes të asaj që të kryhen disa punë dhe që jeta e qytetarëve të Gjilanit të jetë më e mirë dhe asaj që mos të kryhen fare ato punë, këta kanë zgjedh procedurat për t' i kryer ato punë, për të cilin akt rrezikun e marrin njerëzit që punojnë në këto punë dhe unë i falënderoj sinqerisht për guximin e tillë dhe për atë që ndonjëherë kanë rrezikuar.

Abdyl Aliu- edhe dy çështje mbetën për pa u kristalizuar. Unë u keq interpretova dhe nuk kam thënë se menaxherja merr vendim për caktim e komisionit, por e thash mirë se menaxherja e bënë propozimin e dërgon te kryetari i cili e merr vendimin.

Mirëpo e thash se menaxherja kur e propozon veten, ajo është konflikt interesi, qëndroj prapa kësaj fjalie.

Edhe për pagesat që bëhen nga operatori ekonomik edhe në këtë rast qëndroj prapa kësaj, sepse ajo është konflikt interesi.

Menaxherja e tha nuk kemi filluar ne me shkelje, por nga kjo po kuptohet se po vazhdojmë ! Unë në emër të qytetarëve i them të gjithëve nëse diçka keni gjet keq dhe gabim mos e vazhdoni!

Izmi Zeka – e falënderoj shafen e prokurimit për punën të cilën e ka bërë deri më tash, për angazhimet që i ka bërë dhe që kanë qenë të qëndrueshme gjatë gjithë kohës dhe ndryshimet të cilat i ka bërë në këtë zyre. Për ndryshime të cilat janë cilësore, për transparencën që e ka sjell në këtë zyre edhe karshi opinionit edhe qytetarëve dhe për punën shumë të suksesshme.

Kush është për ta aprovuar Raportin e punës së shifes së Zyrës së Prokurimit?

Aprovohet Raporti i punës nga Zyra e Prokurimit me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, 5 kundër dhe 2 abstenime

2/4- Informatë nga Drejtoria e Arsimit për kandidatët e pranuar në shkollat e mesme dhe fillore,

Izmi Zeka – lidhur me këtë pikë do të ishte mirë që kësaj pike t' ia bashkëngjisim edhe atë kërkesën nën të ndryshme të cilën e kërkoj Arben Mehmeti

Bujar Nevzadi- nuk e kam pasur për obligim të sjell informatë këtu, por për shkak të transparencës e kam sjell, prandaj me përgjegjësi të plotë po iu them se kemi vazhduar me punë të suksesshme që nga shtatori e deri më sot dhe garantoj se janë pranuar në procesin mësimor kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet më së miri.

Komisioni i ka ftuar të gjithë të interesuarit dhe në këtë konkurs të dytë nuk kam asnjë ankesë, kurse në konkursin e parë i kemi pasur vetëm dy ankesa.

Lidhur me Shkollën “Abaz Ajeti” të cilën pyetje e bëri znj. Bahrie dhe me plotë përgjegjësi po e them se ajo shkollë është duke punuar sepse këtu ka arsimtarë që punojnë në atë shkollë dhe nuk është mirë të bëhen dezinformata. Unë jam i hapur dhe jam i gatshëm t' i dëgjoj të gjithë ata që japin kritika konstruktive me qëllim të mirë dhe nuk jam për t' u

kthyer prapa, por ne dimë të kaluarën e ndonjë këshilltari të cilët po flasin bukur, por e kanë harruar të kaluarën e tyre. Unë kam përvojë të gjatë të punës dhe po iu them se karrierën time nuk e jap për askënd, as për familjarët mi, miqësi dhe as për këshilltarët. Unë kam trysni nga të gjitha anët, por nuk kam shkuar dhe unë nuk jam në atë detyrë për të punësuar njerëz me lidhje familjare as partiake. Unë drejtor do të qëndroj në DA, derisa unë të marrë vendime të ligjshme dhe pa imponime. Urdhëroni lirisht të gjithë dhe nëse keni argumente për ndonjë keqpërdorim, jam i gatshëm t'iu dëgjoj, por jam i gatshëm edhe në zyrë t'iu pres.

Rashit Sahiti- z. Drejtori theksoi se nuk kam qenë i obliguar që ta sjell këtë informatë, mirëpo ne kemi kërkuar këtë informatë dhe kjo kërkesë e obligon drejtorin për të na informuar për mbarëvajtjen e procesit mësimor në periudha të ndryshme. Mirëpo kam një pyetje sepse në Shkollën e Muzikës për lëndën Edukatë qytetare, është anuluar konkursi, por nuk e di arsyen pse? Në Komunën tonë ka kuadro të mjaftueshëm për këtë lëndë mësimore.

Arben Maliqi- në emër të grupit të AKR-së e përshëndes këtë informatë të DA-së dhe nuk kam asnjë dyshim në aftësitë e drejtorit. Sinqerisht po e them që secili nga drejtorët duhet ta ketë parasysh se ai është i cili vendos dhe zbaton vendime të cilat merren në këtë Kuvend.

Unë e kam vërejt se me rastin e pranimit të kuadrit ka të punësuar edhe arsimtarë të partive tjera dhe këtu shihet drejtori e ka kryer punën ndershëm.

Mirëpo unë i kam disa vërejtje të kriteret e pranimit të punëtorëve e të cilat janë dy: kur është fjala sidomos të vlerësimi i aftësive komunikuese, kush është ai i cili i vlerëson aftësitë komunikuese? Unë mendoj se kjo nuk është korrekte.

Kriteri i dytë i cili për mua nuk qëndron është: që aplikanti t'iu takoj atij lokaliteti?

Këto dy kriteret duhet patjetër të mënjanohen !

Shukrie Rapuca- unë do ta them një gjë e cila u plasua si shumë e pavërtetë në këtë Kuvend, e cila e pavërtetë nuk arsyetohet ndryshe vetëm duke kërkuar falje nga ata të cilët e thanë.

U tha në Shkollën "A. Ajeti", nuk mbahet mësimi e cila gjë është 100% e pavërtetë.

Unë jam aty në dy ndërrime dhe nuk asnjë ditë që nuk është mbajtur mësim me përjashtim të ditëve të festave. Ne kemi defekt në sistemin e ngrohjes, por mësimi mbahet rregullisht, por ora e mësimit zgjatë 30 minuta e kjo zgjatë kështu që plotë 20 vjet.

Shkëlqim Latifi- unë jam kryesues i Komitetit të Arsimit dhe do t'iu them disa fjalë për disa gjëra që u thanë këtu dhe nuk qëndrojnë. Unë jam i mendimit se pranimi i punëtorëve ka qenë korrekt, kriteret janë respektuar me shumë përpikëri. Për këto raste janë vetëm disa ankesa gojore dhe jo me shkrim për ndërrim të kriterëve. Për këtë çështje Komiteti i Arsimit ka debatuar në mbledhjen e kaluar dhe i ka propozuar edhe shefave të grupeve që të hapin këtë çështje, kurs në muajin e ardhshëm do të bisedojmë në Komitet të Arsimit dhe do të debatojmë për korrigjim të këtyre kriterëve.

Ejup Haziri- unë po e ndiej si obligim moral dhe po flas si këshilltar dhe jo si shef i grupit. Po e ndiej obligim moral për ta mbështetur DA-it, sepse kjo Drejtori është ajo e cila në këtë mandat më së shumti ka pasur sfida, sepse konkurrenca ka qenë aty. Po e ndiej si obligim moral, sepse edhe vetë jam anëtar i komisionit dhe kësaj radhe në këtë drejtori dhe në këtë komision nuk ka pasur subjekte politike dhe gjatë punës jemi munduar për ta gjetur më të mirën dhe për ta gjetur kualitetin. Shtrohet pyetja a mund ta gjejmë më të mirën apo jo?

Mirëpo tendenca ka qenë aty dhe qëllim ka qenë për ta gjetur atë më të mirën. Interferenca nuk kemi pasur nga subjekte më të larta nuk kemi pasur dhe sipas të gjitha gjasave puna është kryer më së mirë.

Bahrie Veseli- unë do të kërkoj falje publike nëse kjo që e thash nuk është e vërtetë, por është shumë e vërtetë dhe është fakti se unë fëmijët i kam parë duke u kthyer nga shkolla në mëngjes. Në pyetjen time pse jeni kthyer? Përgjigja ka qenë nuk po mbahet mësim! Është e vërtetë dhe argument se nuk është mbajtur mësimi.

Tjetra është se mbahet mësimi i reduktuar prej orës 9, kurse të gjitha shkollat fillojnë prej orës 7.30 ose 8.00. Gjithashtu mos të themi se komisioni ka qenë i shkëlqyeshëm, por zotëria është shef i grupit parlamentar dhe e përkrah drejtorin, por është edhe ajo çështje punëtorëve teknik, sepse pas anekseve të shkollave, numri i punëtorëve teknik nuk është rritur dhe ata janë shumë të ngarkuar.

Një tjetër fakt është se prej shtatorit arsimtarët që kanë punuar nuk iu ka vazhduar kontrata, por kanë ardhë të tjerë e din komisioni. Në Velekicë ka punuar znj. Ajshe Zahiri prej shtatorit, por është pranuar Gyltene Bajrami. Këtu është bërë një ndërrim dhe kjo është në dëm të nxënësit, sepse nuk është e mirë që nxënësve t'iu ndërrohet arsimtari.

Vërejtje të tilla znj Veseli pati dhe për lëndën e edukatës qytetare, sepse aty ka punuar arsimtari (Samiri), por tash ka ardhur Yllka, Musmurati.

Kërkoj një përgjigje pse nuk janë pranuar këta arsimtarë edhe pse i takojnë këtij lokaliteti ku gjenden shkollat.

Sa i përket kriterëve, ato nuk duhet të ekzistojnë, sepse këto gjëra i parasheh ligji!

Unë jam për atë që të zgjidhet më i mirë dhe mos të ketë kufizime partiake.

Tahir Arfi- unë kam qenë anëtarë i komisionit pa ndonjë vullnet timin, sepse kjo është punë me përgjegjësi dhe shumë e ndjeshme. Do t'iu jap disa përgjigje!

Ligji apo kriteret? Aty ku është në pyetje ligji, kriteret nuk vijnë në konsiderim fare dhe nëse kërkohet profesor i gjuhës shqipe dhe nuk ka kundër kandidatë, këtu nuk ka kriterë.

Kriteret janë bërë për njerëzit të cilët janë në situata të barabarta dhe në 95% të rasteve kësaj here kanë vendosur kriteret. Dy-tri raste kanë vendosur kriteret aty ku thuhet aftësi komunikim dhe njohuri profesionale. Unë nuk kam marrë përgjegjësi për t'iu thënë dikujt se ti bie, sepse duhet tjetri të vijë!

Në lagjen e tetë ka qenë Samiri, por është pranuar një vajzë, por brenda qyteti nuk vlen ky kriteri -kandidati vendas -dhe kandidatë kanë qenë në pozita të barabarta dhe këtu ka vendosur nota mesatare.

Në Velekicë ka qenë konkursi për gjuhë shqipe, kandidatja që është pranuar ka qenë vendase dhe në start i ka marrë 9 pikë, por ajo është edhe profesore e gjuhës shqipe, kurse Ajshe Zahiri nuk i ka pasur ato pikë dhe ka qenë me Shkollë të Lartë (nëse nuk gaboj)?

Pajtohem për ndryshim të kriterëve, por ato duhet të shikohen shumë ngadalë dhe kujdesshëm

Në Shkollën e Muzikës ka qenë vendi i shpallur për edukatë qytetare, por aty kanë qenë 8 orë histori, 8 orë edukatë qytetare dhe 8 orë gjeografi. Në bazë të kësaj konkursi ka qenë i shpallur gabim dhe si komision i kemi preferuar DA-së, për ta anuluar atë konkurs. Ai konkurs do të mund të shpallej si histori-edukatë qytetare, histori –gjeografi dhe gjeografi-edukatë qytetare, por jo vetëm si edukatë qytetare, sepse janë vetëm 4 orë dhe duhet 10 orë për të lidhur kontratë.

Elisah Ymeri- e falënderoj drejtorin për një punë kaq të madhe dhe të suksesshme deri më tani dhe unë nuk kam vërejtje, por e falënderoj edhe për informatën të cilën na e sollti për paqenë i obliguar, por e ka sjell vetëm për shkak të transparencës. Ne jemi dëshmitarë edhe të kohës së më parme për mënyrën se si janë shpallur konkurset dhe çfarë kritere ka pasur. Do t'ia rikujtojë edhe parafolësës e cila ka qenë drejtore në "A. Ajet" që kriter për të ka qenë të jesh në LDK, pranoresh të mos jesh nuk pranoresh! Mirëpo fatmirësisht ky kriter ka ra, por edhe unë jam për atë që të ndryshohen kriteret dhe kam kërkuar edhe më parë ndryshimin e tyre.

Mirëpo më mirë është me një ligj të keq se pa të, por unë kërkoj që të shqyrtohen këto kritere dhe të përmirësohen. E kam edhe një çështje tjetër tek parafolësja e ime dhe i kërkoj që ta rishikoj mendimin e vetë kur thotë se nuk mbahet mësim në Shkollën "Abaz Ajeti", sepse kjo nuk qëndron, sepse unë e kam të punësuar aty edhe bashkëshorten, por edhe fëmijët i kam nxënës të cilët çdo ditë mësimi shkojnë në punë (mësim) dhe kthehen.

Vjollcë Matoshi- unë që nga qershori i vitit të kaluar e kam bërë një kërkesë për institucionet parashkollore, pranë shkollave. Për këtë pyes? Pse u anashkaluan ato dhoma t' i quaja dhoma, sepse në një shkollë janë një apo dy dhoma për fëmijët parashkollor, në të cilat klasë që nga pas lufta nuk është punuar asgjë dhe nuk është investuar asnjë cent. Çdo gjë që shihet në ato klasë është vetëm meritë e prindërve, sepse vetëm ata kontribuojnë për këtë kategori të fëmijëve. Për këtë kategori nuk ka asnjë investim as nga shkolla, por as nga Ministria e Arsimit dhe nuk është bërë investimi as me inventar.

Jashar Jashari- dr. Jashari në këtë seancë paraqiti një kërkesë lidhur me avancimet dhe shpërblimet që duhet t' i bëhen nxënësës së dalluar në Gjimnaz e cila quhet Genta Latifi. Kjo nxënëse me suksesin e saj e ka nderuar komunë e Gjilanit në gara të ndryshme në Kosovë dhe jashtë Kosovës, për të cilën nxënëse duhet pasur kujdes më tepër DA. Mirëpo z. Jashari kërkesën e tij e deponoi me shkrim në sekretari e cila do t' i bashkëngjitet procesverbalit

Bujar Nevzadi- atë që e tha doktori më duket se ka qenë e tepërt, se të gjitha procedurat kanë kaluar përmes DA-së dhe kjo drejtori ka qenë e njoftuar për Gentën. Ne e dimë çështjen e Gentës, por ne si drejtori mendojmë se nxënësit të cilët nuk kanë mundësi të vijnë në shkollë për çështje ekonomike dhe kësaj kategorie i kemi kushtuar vëmendje më të madhe. Ne i kemi thënë edhe prindërit të Gentës që nëse mendon ta dërgosh jashtë Kosovës, ne do të jemi të gatshëm si Drejtori e Arsimit për ta ndihmuar, por këtë dëshirë e ka shpreh edhe kryetari i Komunës.

Çështje bursës do të zgjidhe pa ndonjë problem të madh.

Sa u përket kritereve me ligj tash e tutje i bën DA, por ne jemi të interesuar që përsëri të bisedojmë në Komitet të Arsimit, për t' i diskutuar ato defekte ku i kemi pasur dhe t' i bëjmë më të mira.

Për punëtorë teknik e kemi shpallur një konkurs për 50 punëtorë dhe besoj se këta shumë shpejtë do të jenë nëpër shkolla.

Në fund po them se absolutisht nuk e kemi thënë se nuk ka probleme në shkollat e Komunës së Gjilanit, por disa vërejtje që u dhanë mua ma merr mendja se nuk qëndrojnë. Përndryshe

probleme ka edhe në Gjilan, por dhe në tërë Kosovën. Në suksesin e kemi më të mirin në Kosovë, por përsëri nuk jemi të kënaqur, sepse synojmë shumë më tepër.

Jeni të mirëpritur në zyrën time dhe mirë se vini kur të dëshironi për të biseduar dhe shqyrtuar problemet në arsim.

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me këtë pikë dhe me fjalën e drejtorit të DA-së përfundoi debati

2/5- Propozim-vendimi për ridestinimin e mjeteve të donatorëve për pasojat breshëritë

Izmi Zeka- z, Zeka para këshilltarëve e lexoi propozim-vendimin për këtë çështje.

Mirëpo këto mjete ishin nga donatorët, por komisionet që kanë punuar për këtë çështje kanë pasur disa shpenzime, prandaj ne jemi të detyruar për ta bërë ridestinimin e atyre mjeteve.

Në KPF, kjo çështje ka kaluar, por duhet dhënë pëlqimin edhe KK

Këto mjete kanë qenë për një destinim tjetër, kurse tash duhet ta bëjmë një ridestinim për vlerën harxhimeve nga komisioni të cilat janë 1800 euro e të cilat do të barten nga ai kod në kodin tjetër.

Nuk pati debatues e dhe kryesuesi propozon që të miratohet ky propozim-vendim?

Miratohet pika 2/5 e rendit të punës me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk pati kundër as abstenime

Të ndryshme

Jashar Jashari- edhe kësaj radhe dr. Jashari i paraqiti disa vështirësi me të cilat po ballafaqohet Spitali Regjional i Gjilanit e sidomos në repartin e Emergjencës, por edhe mungesën e barnave kryesore gjatë natës, sepse nuk ka barnatore kujdestare.

Mirëpo të gjitha këto vërejtje dr. Jashari në 1.5 faqe i dorëzoi me shkrim të cilat do të jenë pjesë e procesverbalit.

Tefik Ibrahimimi- unë kisha desh që në një nga seancat e ardhme të kërkohet një Raport nga Polica Regjionale e Trafikut për gjendjen në komunikacion dhe për masat e shqiptuara dhe dënimet që janë bërë ndaj vozitësve. Këtë po e them se kohën e fundit këto dënime janë shumë drastike dhe të papërballueshme për qytetarët tanë.

Në një deklaratë të cilën e kam lexuar, për nëntëmuajorin e vitit të kaluar ka qenë një shumë marramendëse (afër 700 mijë euro dënime).

Kërkoj që në një seancë të na raportojë dikush nga Polica e trafikut për gjendjen dhe masat që po merren për këtë çështje dhe për trafikun në përgjithësi.

Brengosja më e madhe është se gjatë muajve të verës, sepse atëherë kur po kthehen punëtorët nga bota e jashtme, sepse ata në çdo kohë dhe vend janë ndëshkuar.

Xhemajl Salihu- shqetësimi i dr. Jasharit është me vend dhe realisht ky është edhe shqetësimi i imi, por ndoshta ka qenë më korrekt të bëhet vërejtja tek drejtori i Spitalit Regjional, sepse spitali ka për obligim që të posedojë me barëra esenciale.

Çështja e barnatoreve është mjaft specifike dhe me ligj nuk mund ta obligojmë askënd ta detyrojmë për të punuar, me ligj nuk mundemi.

Nuhi Nuhiu- tek ne është bërë presion për të marrë leje për punë 24 orë disa barnatore, por edhe kanë marrë! Halil Shala i ka tri barnatore, prandaj edhe ka reagime për këtë rast, por tash po del se edhe Halili nuk po punuaka! Dy pronarë të barnatoreve tek unë kanë marrë leje për punë për orar 24 orë.

Omer Daku- ne në fund të vitit të kaluar e kemi aprovuar edhe një Rregullore lidhur me Këshillat komunale për siguri në bashkësi, ku sipas asaj rregulloreje në këto takime do të marrin pjesë të gjitha partitë politike përmes përfaqësuesve të tyre. Në këto takime do të jenë edhe Policia e Kosovës, gjegjësisht komandantin e policisë i cili gjithmonë raporton dhe nëse pajtoheni në këtë çështje do ta debatojmë në takimet e radhës dhe aty do të debatojmë. Nga ky takim materiali do t' i silltet të gjithë këshilltarëve.

Elisah Ymeri- unë më parë e kam paraqit një kërkesë timen për bexha, sepse ne duhet të kemi simbole identifikuese se jemi këshilltarë komunal, prandaj iu lus që ta përmbushni këtë kërkesë.

Sami Azemi- është një shqetësim i qytetarëve tanë të cilët nuk kanë qasje në dokumente personale si në shtetësi dhe këtu është fjala për të gjithë shqiptarët e shpërngulur nga Kosova Lindore e që ai numër arrin afër 12 mijë. Në periudhën e vitit 2000, pjesa më e madhe është regjistruar dhe pajisur me dokumente personale, por pas Pavarësisë së Kosovës, ato dokumente më nuk janë valide! Për ta marrë një shtetësi duhet një mori dokumentesh, por ata duhet të pajisen edhe me vërtetim se nuk janë nën hetime dhe ndaj tyre nuk janë shqiptuar masa gjyqësore. Si të nxirret ky dokument kur një pjesë e tyre janë të ndjekur dhe kanë akuza në Serbi.?

Mandej këta që aplikojnë për shtetësi duhet të paguajnë 150 euro për individ e cila shumë është tepër e madhe. Kërkoj që këtyre qytetarëve t' i mundësohet që më me lehtësi t' i mundësohet pajisja me dokumentacion!

Shkëlqim Latifi- unë po shpreh një shqetësim si këshilltarë komunal, sepse kohë pas kohe duhet të kryejmë edhe punë, personale, por edhe zyrtare në qytet, por nuk kemi vend për parkim të automjeteve tona. Do të ishte mirë që në qytet, krahas veteranë të cilët kanë qasje në autoparkimje për të shfrytëzuar një orë pa pagesë, këtë privilegj ta kenë edhe këshilltarët komunal.

Tahir Arfi- unë e di që ka pas filluar një procedurë për lap-top për këshilltarët komunal, por nuk e di ku ka mbet kjo procedurë?

Dhe e dyta të gjithë jeni të informuar se disa të rinj të Luginës së Preshevës i quajtur “Grupi i Gjilanit” janë dënuar me 101 vjet burg dhe për shkak të emërimit “Grupi i Gjilanit”, ky Kuvend do të duhej të lëshojë një deklaratë mbështetëse për familjet e tyre dhe një kundërshtim për regjimin e Beogradit.

Arben Dubova – një sqarim rreth dokumentit të shtetësisë i cili u ngrit këtu, sepse ne çdo ditë po merremi me probleme të kësaj natyre dhe kjo është shumë shqetësuese edhe për ne si Drejtori e Administratës. Mirëpo çështje e shtetësisë është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, por edhe taksat që u përmenden, Komuna nuk inkason asnjë cent.

Komuna i inkason vetëm 2 euro në momentin kur bëhet aplikim për shtetësi, kurse procedurat për shtetësi i rregullon Ligji për shtetësi.

Çështja e dokumentit të gjykatës i cili dokument është i rregulluar me ligj dhe të gjithë ata që janë të ndjekur politikisht në qoftë se kanë dëshmi janë të liruar nga pajisja e këtij dokumentacioni, kurs të gjitha të tjerat janë të rregulluara me ligj dhe komuna vetëm e kryen shërbimin e kompletion dokumentacionin dhe i përcjell në njësitë përkatëse.

Izmi Zeka- çështje e bekhava, shefja e Zyrës së Prokurimit duhet shumë shpejtë ta përfundojë. Ajo çështja e llap-topave është në procedurë të tenderimit, sepse ka mbetur për shkak të ofertave jo serioze.

Jam për atë që raporti i policisë të vijë në Kuvend, pastaj ta bëjmë një raport përfundimtar. Pajtohem që një deklaratë të përpilohet në emër të KK-së për dënimin e “Grupit të Gjilanit” Përpilimin do ta bëjmë, brenda një ose dy ore për tërë opinionin Kosovar dhe më gjerë.

Kush është që të bëhet një deklaratë në emër të KK-së, lidhur me dënimin e “Grupit të Gjilanit”

Me vota unanime u miratua propozimi që të bëhet një deklaratë e tillë në emër të KK-së Gjilan

Seanca përfundoi punimet në ora 13.45 min

Procesmbajtësi

Sali. HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi. ZEKA